



# Dizajn dhe Teknologji Druri

## 1. Pse një Master në “ Dizajn dhe Teknologji Druri”

- ✚ Ka vazhdimsi akademike, njohuri dhe aftesi profesionale  
Programi i Masterit siguron një vazhdimësi akademike për të diplomuarit e bachelorit në “Inxhinieri e Drurit dhe Dizajn Interieri”, duke mundësuar specializim të avancuar dhe duke parandaluar fragmentimin akademik
- ✚ Kompetenca ndërdisiplinore dhe inovacion  
Programi integron teknologjinë e drurit, shkencën e materialeve dhe dizajnin, duke nxitur aftësi ndërdisiplinore të domosdoshme për inovacion në industritë bashkëkohore të bazuara në dru. Kualifikim profesional
- ✚ Ai i përgjigjet kërkesës në rritje për profesionistë të kualifikuar të aftë për të aplikuar teknologji të qëndrueshme të drurit, parime të dizajnit qarkullues dhe procese të avancuara prodhimi.

## 2. Kompetencat e të diplomuarve

- ✚ Njohuri mbi Materialet dhe Produktet Inxhinierike – Kuptim i thelluar i vetive, aplikimeve dhe performancës së materialeve inxhinierike të drurit dhe produkteve të ndërtimit, me aftësinë për të përzgjedhur dhe integruar materiale të përshtatshme bazuar në kriteret strukturore, funksionale dhe të qëndrueshmërisë.
- ✚ Teknologjia e Konstruktiveve prej Druri – Kompetencë në projektimin dhe analizimin e strukturave prej druri në përputhje me standardet inxhinierike dhe specifikimet teknike.
- ✚ Kompetencë në zhvillimin e dizajnit të interierit – Aftësi që ndërthurin funksionalitetin praktik, efikasitetin hapësinor dhe cilësinë estetike në kontekste të ndryshme. Aftësi të avancuara në përdorimin e programeve të modelimit dhe mjeteve të simulimit vizual për konceptim, zhvillim të dizajnit dhe prezantim të projekteve të interierit.

## 3. Punëdhënësit e mundshëm dhe/ose rruga e karrierës

Potencialisht, të diplomuarit mund të punësohen

- ✚ Inxhinier i Prodhimit dhe Kontrollit të Cilësisë  
Punësim në industritë e përpunimit të drurit, me përgjegjësi për menaxhimin e proceseve të prodhimit, performancën e materialeve dhe sigurimin e cilësisë së produkteve të drurit.
- ✚ Specialist i Dizajnit të Interierit dhe Teknologjisë së Drurit

Angazhim profesional në studio dizajni interieri dhe kompani ndërtimi, duke integruar materialet e drurit, zgjidhjet teknologjike dhe parimet e dizajnit të qëndrueshëm.

✚ Konsulent Dizajni dhe Teknik për Showroom Mobiljesh

Punësim në showroom-e të mëdha mobiljesh, me përgjegjësi për organizimin e hapësirës, prezantimin e produkteve, ofrimin e këshillimit teknik mbi materialet e drurit dhe sistemet e mobiljeve, si dhe mbështetjen e klientëve në përzgjedhjen e zgjidhjeve funksionale dhe estetike të përshtatshme

**4. Alumni të cilët mund të shërbejnë si shembull**

- ✚ Auklent Myftaraj, Erald SH.P.K
- ✚ Orest Prifti, Bross architecture studio
- ✚ Shemsi Plaku, Buna Company
- ✚ Genta Ahmeti, Life on the boat, owner CEO
- ✚ Erjon Kotani, Saloni sh.p.k

**5. Si zbatohet ndërdisiplinarteti i programit?**

- ✚ 24 % ECTS në Shkencat Natyrore (minimumi 15%)
- ✚ 28 % ECTS në Shkencat Teknike/Inxhinierike (minimumi 15%)
- ✚ 16 % ECTS në Shkencat Sociale (minimumi 15%)
- ✚ 14 % (12 kredite) në lëndë të gjuhës angleze (minimumi 10 kredite)
- ✚ 32 % të tjera (Ekskursionet, seminar i masterit, praktikë profesionale/trajnim praktik, temë diplome)

**6. Cilat programe Bachelor sugjerohen për këto Master**

- ✚ Dizajni i mobiljeve dhe interierit
- ✚ Inxhinieri Perpunim druri
- ✚ Dizajni i interierit dhe Inxhinieri Druri
- ✚ Inxhinieri pyjore
- ✚ Arkitekture peisazhi
- ✚ Arkitekture Dizajn